

K.R.U. "GJAKOVA" SH.A. GJAKOVË			
Marrë në datën: 02.02.2023			
Njësia org.	Numri	Shënjestra	Vlera
	856		



Kompania Rajonale e Ujësjellësit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-087, "Mbi Ndërmarrjet Publike", i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe Ligjin Nr.05/L-009, Bordi Drejtorëve në mbledhjen nr 6 të mbajtur me datë 29.12.2022 bazuar në Vendimin e ARRU të datës 08.11.2022 për plotësimin e Rregullore NR 01 -2017 për zgjidhjen e ankesave të Konsumatorëve, Rregullore NR 02-2017 Për Procedurat e Lidhjes se Konsumatoreve ne shërbime të Ujit, Rregullore NR 03-2017 Për Procedurat e Ndërprerjes së Sherbimeve të Ujit, Rregullore NR 04 -2017 për Procedurat e Faturimit për shërbimet e Ujit, Rregullore NR 05- 2017 për Matjen e Konsumit të Ujit në KRU'Gjakova'SH.A-Gjakovë muarr

VENDIM

Unanimisht aprovohen plotësim ndryshimet e Rregulloreve të Kompanisë.

- Rregullore NR 01 -2017 për zgjidhjen e ankesave të Konsumatorëve,
- Rregullore NR 02-2017 Për Procedurat e Lidhjes se Konsumatoreve ne shërbime të Ujit,
- Rregullore NR 03-2017 Për Procedurat e Ndërprerjes së Sherbimeve të Ujit,
- Rregullore NR 04 -2017 për Procedurat e Faturimit për shërbimet e Ujit,
- Rregullore NR 05- 2017 për Matjen e Konsumit të Uji

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi Drejtorëve dhe nënshkrimin nga Kryesuesi Bordit Drejtorëve.

Kryesues i Bordi të Drejtorëve

Z. Urim Gashi





Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORMI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



582/2
08/11/2022

Në mbështetje të nenit 4, paragrafi 3.6 dhe nenit 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, duke u bazuar në kërkesën nr. 2765 datë 07.11.2022 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRU "Gjakova", për aprovimin e Rregullores me nr. 07/2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregulloreve përkatëse të brendshme të kësaj kompanie, Drejtoresha e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet Rregullorja Nr. 07/2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2017 për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve, Rregullores Nr. 02/2017 për Procedurat e Lidhjes së Konsumatorëve në Shërbimet e Ujit, Rregullores Nr. 03/2017 për Procedurat e Ndërprerjes së Shërbimeve të Ujit, Rregullores Nr. 04/2017 për Procedurat e Faturimit për Shërbimet e Ujit dhe Rregullores Nr. 05/2017 për Matjen e Konsumit të Ujit.
2. Për zbatimin e kësaj Rregullores sipas pikës 1 të këtij vendimi, obligohet të përkujdeset Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Gjakova" SH.A Gjakovë.
3. Rregullorja e cekura në pikën 1 të këtij vendimi, fillon së zbatuarit, shatë (7) ditë pas nënshkrimit dhe publikimit të saj, në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të K.R.U "Gjakova".
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit.

T'i dërgohet;
1x Arkivit të ARRU
1x Kryeshefit Ekzekutiv KRU "Gjakova"

Drejtoresha

Hajrije MORINA